



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 30.3.2023

Nr: 219

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK, BASHKIA TIRANË, TË DEPOZITUAR NGA PARTIA "FRONTI I MAJTË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, nenit 67, nenit 72 dhe nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar si dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore",

V Ë R E J:

Partia "Fronti i Majtë", me vendimin nr. 143, datë 8.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Fronti i Majtë", për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, Partia "Fronti i Majtë" ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të partisë "Fronti i Majtë" dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërbushje të dokumentacionit si më poshtë:

Data: 30.3.2023 Nr: 219  
Ora: 11:00



"Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të depozituar nga partia "Fronti i Majtë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

- Konstatohet se kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, nuk respekton kuotën gjinore sipas pikës 6, të nenit 67 të Kodit Zgjedhor.
- Konstatohet se lista shumemërore e kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë mbyllet me numrin rendor 32 (tridhjetë e dy). Kjo listë nuk është në përputhje me pikën 4, të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kandidatëve në listën shumemërore të përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vendimin nr. 100, datë 8.3.2023 “Për caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, i ndryshuar. Në referim të sa më sipër, lista shumemërore duhet të ketë 62 (gjashtëdhjetë e dy) kandidatë.
- Konstatohet se disa prej emrave të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, figurojnë në listat shumemërore të një partie tjetër.

Në zbatim të nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar i kthehet për korrigjim subjektit zgjedhor “Fronti i Majtë”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

#### **V E N D O S:**

1. Kthimin për korrigjim, për gjetjet e renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor “Fronti i Majtë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 31.03.2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**